

**LUAN KOKONA**

### MENDIME RRETH METODËS ARTISTIKE TË MIGJENIT

Një nga problemet më pak të studjuara të shkencës sonë letrare është ai i rrymave dhe metodave artistiko-letrare, që janë dukur në historinë e letërsisë shqipe. Kohët e fundit në këtë lëmë po vihet re një farë gjallërimi. Studjuesit kanë filluar të tregojnë interesim për këtë problem. Shkrimtari, që ka tërhequr më tepër vëmendjen në këtë vështrim është Migjeni<sup>1</sup>, parimet krijuese të të cilit po rrihen e shoshiten gjithënjë e më shpesh. Sqarimi i çështjes së metodës artistike që përdori Migjeni ka rëndësi jo vetëm për të njohur më thellë veprën e tij, po edhe për ndriçimin e historisë së rrymave dhe drejtimeve në letërsinë shqipe. Lidhur me metodën krijuese të Migjenit janë shprehur mendime të ndryshme. Disa autorë kanë pikëpamjen, se letërsia e realizmit socialist në Shqipëri nis gjatë periudhës së sundimit të A. Zogut dhe se ndër përfaqësuesit e saj kryesorë është edhe Migjeni. Të tjerë mendojnë se Migjeni është shkrimtar realist. Problemi nuk është zgjidhur dhe diskutimi mbetet i hapur.

Në përpjekjet e tyre për të hetuar parimet artistike mbi të cilat u mbështet Migjeni, disa autorë, sipas nesh, nuk kanë mundur të përcaktojnë sa duhet qartë rrethanat politiko-shoqërore, në të cilat hodhi rrënjë dhe u zhvillua krijimtaria e shkrimtarit tonë të shquar, e tok me këtë s'kanë formuluar saktë detyrat historike të epokës së tij. Në kumtesën tonë bëhet përpjekje për ta hetuar natyrën e metodës artistike të Migjenit nëpërmjet përcaktimit më të qartë të premisave shoqërore-politike të veprimtarisë së tij letrare e të zbulimit të karakterit tipik, të përgjithësuar, të situatave dhe figurave të shkrimeve të tija. Cila qe koha, kur jetoj dhe krijoi Migjeni dhe ç'detyra shtronte para letërsisë shqipe zhvillimi historik? Një kuadër të saktë të gjendjes së vendit gjatë regjimit të A. Zogut, gjejmë në raportin e sh. Enver Hoxha, mbajtur në Kongresin e I-rë të Partisë Komuniste të Shqipërisë, «Në regjimin e Zogut — thuhet në raport — vazhduan ato raporte ekonomike feudale të sundimit turk. Pushteti ishte në duart e bejlerëve të rritur dhe të edukuar në ambientin e perandorisë turke. . . .

1) Rreth këtij problemi kanë çfaqur mendime në punime dhe artikuj të tyre: Dhimitër S. Shuteriqi, *Migjeni (1938-1948)*, rev. «Literatura jonë», Tiranë, 1948, nr. 8, f. 1-14; Vehbi Bala, *Milosh Gjergj Nikolla (Migjeni) (1911-1938)*, «Bul. për Shkenc. Shoq.», Tiranë, 1954, nr. 1, f. 55-76; Arif Gjyli, *Migjeni poet i realizmit socialist*, «Bul. për Shk. Shoq.» Tiranë, 1957, nr. 2, f. 135-195; Razi Brahimi *Fillimet e letërsisë sonë të realizmit socialist*, gaz. «Drita», Tiranë, 1961, nr. 49, 3 dhjetor, f. 2-3 dhe vazhdimi po aty, nr. 50, 10 dhjetor f. 2; Koço Bihiku, *Rreth problemit të lundjes së realizmit socialist në letërsinë shqipe*, kumtesë e lexuar në Konferencën e Studimeve Albanologjike, Tiranë, nëndor 1962, dhe diskutimet rreth saj të Drago Siliqit, Dhimitër S. Shuteriqit, Razi Brahimit, Mark Gurakuqit; si edhe studjonjës të tjerë.

Vazhdimi i raporteve feudale gjer në këtë kohë në vëndin t'onë për shkak të sundimit otoman, shpjegon faktin që borgjezia nuk mundi të zhvillohesh me kohë...»<sup>2</sup> dhe më poshtë:

«Sa për industrinë nuk munt të flitet fare në këtë periudhë të errët të këtij regjimi. Industria e lehtë përbënte një pjesë shumë të vogël të ekonomisë dhe nga ana teknike ajo ishte fare primitive, dhe nënë drejtimin direkt të kapitalit tregëtar feudal-borgjez të vëndit, i cili sa po kish filluar të shtrihesh fare pak n'industri i mbështetur kurdoherë në ndihmën dhe në drejtimin e dëshëruar nga kapitali i math financiar italian, interesat e të cilit nuk e pëlqenin zhvillimin e industrisë së lehtë në vëndin tonë; prandaj industria nuk mori asnjë zhvillim...»<sup>3</sup>

Shqipëria atëhere ishte një vend i prapambetur bujqësor. Pjesa më e madhe e popullsisë merrej me punimin e tokës. Fshati shqiptar i viteve '30 ishte lidhur duar e këmbë nga mbeturinat e marrëdhënieve feudale, të cilat u merrnin frymën forcave të reja prodhonyese. Fshatarësia ishte kredhur në një varfëri të madhe; ajo rronte në padije dhe bënte një jetë të rëndë, të privuar prej gjërave dhe mjeteve më elementare për ekzistencën e vet. Reforma agrare mbeti një ëndër për fshatarin tonë, sepse pushtetin e patën në duar klikat që zotëronin çifligje të mëdha.

Kështu, për shkak të pengesave nga ana e marrëdhënieve feudale, industria që zhvilluar pak dhe bujqësia shkante drejt rënies. Shqipëria ishte kthyer në një vend gjysmë kolonial. Masat punonyese vuanin nën shtypjen dhe shfrytëzimin e rendit çifligaro-borgjez dhe të kolonialistëve italianë.

Gjatë viteve '30 klasa punëtore e vëndit ishte relativisht e re, e vogël në numër dhe e paorganizuar. Ajo sapo nisi luftën për plotësimin e disa kërkesave ekonomike. Në të nuk që futur ndërgegja socialiste. Udhëheqja revolucionare e vërtetë e saj, partia komuniste, ende nuk që krijuar. Kishte vetëm grupe komuniste, të cilat ishin në hapat e para të zhvillimit të tyre.

Detyrat themelore që shtroheshin në atë kohë para forcave demokratike qenë rrëzimi i monarkisë çifligaro-borgjeze të A. Zogut dhe vendosja e një regjimi demokratik të përparuar, çlirimi i vëndit nga mvartësia ekonomike e Italisë, zgjidhja e çështjes agrare, etj. Ali Kelmendi, më 1936, në një relacion mbi aktivitetin e grupeve komuniste në Shqipëri, shkruante: «Të krijohet një organizatë e bashkuar ilegale mbi një platformë të përgjithëshme mbi luftën kundër regjimit të sotmë dhe imperiaлизmit italian, për një republikë demokratike dhe për likujdimin e marrëveshjeve skllavëruese me Italinë fashiste»<sup>4</sup>. Këto qenë detyra të një revolucionit demokratiko-borgjez.

Në përputhje me këto kërkesa, për realizimin e të cilave luftonin forcat demokratike të vëndit, u zhvillua edhe letërsia përparimtare shqipe e kohës, e cila gjeti mbështetje në shtypin përparimtar të kohës. Revista «Bota e Re», e krijuar me inisiativën e grupit komunist të Korçës, «lojti, në kushtet e regjimit zogist, një rol të rëndësishëm në demaskimin e këtij regjimi dhe të klasave shfrytëzuese që e mbështetnin atë. Ajo kontribuoi

2) Enver Hoxha, *Raport në Kongresin e I-rë të Partisë Komuniste të Shqipërisë*, botim i K.Q. të PPSH, Tiranë, 1949, f. 17-18.

3) *Po aty*, f. 21.

4) Ali Kelmendi..., *Nga raporti i Ali Kelmendit mbi aktivitetin e tij dhe të grupeve komuniste në Shqipëri gjatë viteve 1932-1936*, Instituti i Historisë së Partisë,

në shkallë të gjerë për përgatitjen politike dhe ideologjike të inteligjencës në mënyrë të veçantë të rinisë shkollore, për të luftuar regjimin zogist dhe fashizmin»<sup>5</sup>. Revistat e tjera përparimtare i vunë gjithashtu si qëllim vehtes luftën kundra botës së vjetër dhe errësirës, për një rend demokratik dhe për përparimin ekonomik e shoqëror. Në kuadrin e luftës ideologjike, p.sh. «Bota e Re» shtronte kërkesën për një kulturë të popullit, për një art dhe letërsi realiste, duke luftuar kundër teorisë së «artit për art». N. Bulka, Dh. S. Shuteriqi, P. Marko, etj. shkruanin për «drejttime» dhe «horizonte të reja» në letërsinë kombëtare, për një letërsi realiste, e cila duhej të pasqyronte jetën e masave popullore.<sup>6</sup> Shumica e shkrimeve që botuan atëherë N. Bulka, P. Marko, K. Cepa, Migjeni, etj. lidheshin me jetën e kohës dhe u bënë jehonë halleve të popullit, pasqyronin varfërinë dhe mjerimin e puntorëve, fshatarëve dhe shtresave të ndryshme, demaskonin despotizmin dhe injorancën e regjimit të Zogut, vinin gishtin në plagë të mëdha shoqërore, si në të papunësisë, përhapjes së prostitucionit, mashtrimit fetar, korrupsionit të nëpunësive, etj. Në krijimet e tyre shkrimtarët përparimtarë treguan se sa larg nevojave dhe halleve të vërteta të popullit ishin organet burokratike shtetërore, përshkruan gjendjen e padurueshme të gruas, zhveshur prej të drejtave elementare, ngritën zërin kundër depërtimit të imperializmit dhe të fashizmit italian. Ata, megjithëse në formë të mjegullt, shprehën aspiratën për drejtësi shoqërore, për një regjim të ri. Në shkrimet e tyre gjejmë jo vetëm një tematikë të re, motive e figura të reja, po te disa syresh vihet re një kënd i ri shikimi të fenomeneve të jetës.

Përpjekja për të qënë sa më pranë jetës së popullit, për t'u frymëzuar nga brengat dhe hallet, që preokuponin shtresat demokratike të qytetit, u përkrah fuqimisht nga organet «Bota e re», «Rilindja» etj. Në faqet e tyre u shtrua me të madhe kërkesa për krijimin e një letërsie me frymë demokratike, «letërsi kombëtare realiste»<sup>7</sup>.

Për të vërtetuar se po formohej një letërsi e realizmit socialist disa studjues pohojnë se lëvizja punëtore që po zhvillohej me shpejtësi kërkonte formimin e një letërsie socialiste. Një pohim i tillë bie në kundërshtim me faktet historike e letrare. Në ato vite vërtet kemi veprimtari në grupet komuniste, por detyrat për zgjidhjen e të cilave ato punonin nuk kishin karakter socialist. Më 1937 Ali Kelmendi shkruante se përpara komunistëve shqiptarë shtrohej detyra për nxjerrjen e një broshure që «do të qe hapi i parë dhe i sigurt i literaturës sonë me frymë demokratike anti-fashiste, me formula konkrete që t'u hapim sytë shokëve tonë jashtë e brënda»<sup>8</sup>. Edhe në aspiratën për ditë më të mira që u shpreh në krijimet e autorëve përparimtarë gjithashtu nuk diktojmë brendi socialiste. Ajo lidhet me dëshirën për rrëzimin e sundimit të Zogut si regjim të despotizmit, të arbitraritetit, si sistem politik e shoqëror regresiv.

5) Historia e Shqipërisë 1925-1939 (maket për diskutim), *Lufta ideologjike në Shqipëri në vitet '30*. Inst. i Hist. dhe i Gjuh., Tiranë, 1964, f. 64.

6) Shih artikujt e P., *Në prakun e drejtmeve të Rea Letrare*, rev. «Bota e Re», Korçë, 1936, nr. 1, 15 prill, f. 14-15; Dh. S. Shuteriqi, *Drejtmet e rea letrare*, po aty, nr. 2, 30 prill, f. 7-9, N.B. *Për një letërsi të re*, po aty, nr. 3, 15 maj, f. 10-11; Dh. S. Shuteriqi, *Prap mbi «Drejtmet e rea letrare»*, po aty, nr. 4, 1 qershor f. 9-11; Dh. S. Shuteriqi, *Prap mbi «Drejtmet e rea letrare»*, po aty, nr. 6, 30 qershor, f. 10-11; Dh. S. Shuteriqi, *Prap mbi «Drejtmet e rea letrare»*, po aty, nr. 7, 15 korrik f. 9-11.

7) N.B. *Për një letërsi të re*, rev. «Bota e Re», Korçë, 1936, nr. 3, 15 maj, f. 10.

8) Ali Kelmendi..., vëllim i cituar, f. 42.

Kur flasim për elementet e reja në letërsi lidhur me lëvizjen puntore duhet pasur parasysh se edhe kur ka lëvizje socialiste, shtyp socialist, etj., jo gjithënjë kemi të bëjmë me letërsi gjithashtu socialiste, sepse lufta e klasës puntore dhe forcave përparimtare jo gjithënjë ka përmbajtje socialiste.

Shoku Mao Ce Dun, më 1940, duke folur lidhur me kushtet për lindjen e ideologjisë dhe të kulturës së re në Kinë, në procesin e luftës anti-imperialiste çlirimtare, ka theksuar: «Duke qënë socialiste nga përmbajtja, kultura popullore duhet të pasqyrojë politikën dhe ekonominë socialiste. Në politikën dhe në ekonominë tonë ka elemente socialiste të cilët pasqyrohen edhe në kulturën tonë popullore. Përsa i përket shoqërisë në tërësi, tek ne nuk është formuar akoma, plotësisht politika socialiste dhe ekonomia socialiste, prandaj nuk mund të ketë një kulturë kombëtare krejt socialiste... Ashtu sikurse revolucioni i sotëm kinez nuk mund të bëhet pa udhëheqjen e proletariatit kinez, ashtu edhe kultura e re e tanishme e Kinës nuk mund të ndahet nga udhëheqja e ideve të kulturës proletare të Kinës, d.m.th. nga idetë komuniste; me gjithë këtë, meqënëse detyra e fazës së tanishme qëndron në udhëheqjen e popullit drejt kryerjes së revolucionit politik dhe kultural antiimperialist dhe antifeudal, përmbajtja e kulturës së re kombëtare të Kinës në përgjithësi nuk është socialiste, por e re demokratike»<sup>9</sup>.

Pak a shumë rrethana analoge, në mos më pak të favorëshme, ekzistonin edhe në Shqipëri në vitet '30 në lemin e jetës politike e shpirtërore.

Në rrethanat e lëvizjes demokratike antizogiste dhe antifashiste, kur kishte një klasë puntore të re e të paorganizuar, kur mungonte partia e saj, kur lëvizja puntore ishte në hapat e saja të para, nuk ishte e mundur që të kishte edhe një kulturë socialiste dhe letërsi të realizmit socialist.

Krijimtaria e shkrimtarëve përparimtarë ishte e lidhur me detyrat e lëvizjes demokratike të popullit kundra monarkisë çifligaro-borgjeze dhe depërtimit të imperializmit italian. Në krijimet e veta ata stigmatizuan shtypjen e ashpër politike dhe ekonomike, qëndrimin çnjerëzor ndaj njeriut të popullit, abuzimet dhe akroballekun në aparatit shtetëror, trajtuan gjendjen e bujkut dhe të gruas, etj.

Po le të analizojmë veprën e Migjenit, përfaqësuesit më të çqar të letërsisë sonë demokratike të viteve '30, nga pikëpamja e parimeve themelore estetike.

Migjeni kishte si qëllim që nëpërmjet pasqyrit realist të mjerimit të popullit të nxiste forcat e reja që të luftonin «për një agim të lum e të drejtë kombtar»<sup>10</sup>. Duke u nisur nga ky qëllim ai eci si shkrimtar, në përgjithësi, në rrugën e parimeve të metodës së realizmit, që u shpreh në përshkrimin e vërtetë objektiv të jetës, dhe në krijimin e figurave tipike në rrethana tipike.

Siç e pamë, gjatë viteve që shkroi Migjeni, si pasojë e shfrytëzimit të egër të feudo-borgjezisë, e shtypjes barbare të regjimit në fuqi, populli po kalonte një gjendje shumë të rëndë ekonomike. Fshatari kishte

9) Mao Ce Dun, Mbi artin dhe letërsinë, N.Sh. Botimeve «Naim Frashëri», Tiranë, 1961, f. 32-33.

10) Migjeni, *Të lindet njeriu...*, VEPRAT, N.SH. e botimeve, Tiranë, 1957, f. 62.

rënë në një varfëri të madhe dhe konsiderohej pa dinjitet nga klasat në fuqi. Papunësia shtohet gjithënjë e më tepër, lypësit endeshin poshtë e përpjetë, prostitucioni degjeneronte njerëzit, mashtruesit fetarë me hipokrizinë e tyre mbanin në errësirë masat. Kontradiktat ndërmjet të varfërve e shfrytëzuesve, ndërmjet forcave demokratike e regjimit diktatorial, ndërmjet ideve përparimtare e fesë, sa vinin e acaroheshin. Migjeni pasqyroi këto kontradikta. Në krijimet e tij kjo gjendje, në të cilën e kishte çuar vendin regjimi i Zogut, gjeti një pasqyrim të thellë e realist.

«Legjenda e misrit» është një përgjithësim i gjendjes së vështirë në të cilën qe katandisur fshatari ynë. Aty kemi një pamje të thellë realiste, në të cilën tregohet zhdukja në karakterin e malësorit shqiptar, para frikës së urisë, e tipareve karakteristike, që e kanë çuar për shekuj, si të trimërisë, ndjenjës së dinjitetit personal, etj. «... Krahnori i tij asht një copë graniti që u shkëput nga mali dhe u vendos mbi dy kambë të drejta e të forta si landa e pyllit. Dhe lëvizet copa e malit pa bëzajtë. E përpara depos së misrit bjerr cilsin karakteristike të vetën, dhe bahet frigacak. Bahet servil, frigacak, pse, — mendoi ai — nj'ashtu e don ligji, nëpunsi; përndryshe s'ka misër. «Si urdhnon, zotni» përsritet sa e sa herë në mnyrë qesharake, me të marrun zani. . .»<sup>11</sup>

Te «Moll'e ndalueme» krijoi me ngjyra të gjalla figurën tipike të puntorit të papunë të viteve '30, dramën e tij, që u shpreh me pamundësinë për të vënë në zbatim forcën e vet fizike në dobi të vehtes dhe të shoqërisë.

Varfëria dhe mjerimi i masave punonjëse është tema qëndrore e krijimtarisë së Migjenit. Në veprën e tij, me vërtetësi e thellësi, me anë figurash tipike, ai pasqyroi papunësinë («Moll'e ndalueme», «Novelë mbi krizë»), prostitucionin («Baladë qytetse», «A do qymyr, zotni?», «Historija e njenës nga ato»), mashtrimin fetar («Kanga skandaloze», «Në kishë»), çthurjen morale të borgjezisë tregtare («Studenti në shtëpi», «Të çelen arkapijat»), duke zbuluar shkaqet e papunësisë dhe të prostitucionit, duke demaskuar moralin fetar dhe atë borgjez, etj.

Migjeni tregoi nivelin ende të ulët të ndërgjegjes klasore të masave punonjëse, duke marrë kështu vepra e tij rëndësi njohëse. «Kush ka faj? — Kola thotë askush s'ka faj — dhe aty qëndron e tanë tragjedia e tij. Vujejtja intime dëshpruese, e cila t'udhëheqë në vetvrasje. Por mirë asht që Kola mendonte ashtu e jo ndryshe. Ta dinte ai se kush e ka fajin, ose së paku t'i a kishte vue ai — vetë kuej fajin, atëhere — eh atëherë... Fuqitë e njerëzvet n'ankant kushedi si do të veprojnë»<sup>12</sup>. Edhe te «Moll'e ndalueme»: «... Puntori ynë sundon vehten! Ligji! Polici! Për sigurim duertë i ve mbrapa. E duertë e tija janë të forta, të fuqishme. Edhe dreqin e kishin kapë për fytit dhe e kishin mbytë. Por edhe dreqin e mbron ligji»<sup>13</sup>. Kola s'e dinte kush e kishte fajin; puntori i papunë sundonte vehten e vinte duart mbrapa, sepse e vëzhgonte polici, e ruante ligji.

Në veprën e Migjenit gjenin shprehje kontradiktat e kohës, anta-gonizmi ndërmjet masave të varfëra e të çfrytëzuara dhe klasave në fuqi, çifligarëve dhe borgjezisë tregëtare, ndërmjet regjimit obskurantist dhe forcave demokratike përparimtare. Në «Kanga skandaloze» ai shkruan:

11) *Legjenda e misrit*, vëllim i cituar, fq. 141.

12) *...Bukën tonë të përditshme falna sot...*, vëllim i cituar, fq. 196.

13) *Moll'e ndalueme*, vëllim i cituar, fq. 125.

«Unë edhe ti murgeshë, dy skaje po të një litari,  
të cilin dy tabore i a ngrehin njeni-tjetrit —  
lufta asht e ashpër dhe kushedi ku do të dali,  
prandaj ngrehet litari edhe përplasen njerzit.»

Përfaqësuesit e vegjëlisë së varfër tek Migjeni jo vetëm vuajnë, por edhe protestojnë për gjendjen, në të cilën janë hedhur. Në kishë lypësi «... u çue, duel jashtë, e te dera, mbasi plot mni e nderoi padren, me një të shame, pëshpëriti: «Po si do të jetoj unë?»... këtë kurr s'ma the. E unë pra due të jetoj!»<sup>14</sup>.

Migjeni u ngrit kundër shfrytëzimit dhe shtypjes së ashpër ekonomike e shoqërore, kundra varfërimit dhe kredhjes së vijueshme të popullit në mjerim. Lypsi «Kujtohet si i ka ndihmue lypsat që vishin ditë shtunde në prakun e dyqanit të tij, kur ishte farkatar... E sot? Atij pak kush i ndihmon, pse janë shumë lypsa. Kujt t'i epet ma parë? Arsyetonte lypsi së fundi. Por mnija vetvetiu, pa arsye, rritej e pushtonte zemrën dhe trunin e tij dhe m'at çast donte të shfrejë në një mënyrë — makare tue rrahë hekurin e kuqun. E kur nuk ka hekur dhe çekiç. Puna del e dyshimtë dhe e rrezikshme»<sup>15</sup>.

Migjeni stigmatizoi të pasurit që e çonin jetën «... si një gotë shampanjë»<sup>16</sup>, malin që heshte (regjimin e Zogut), kryqet e minaretë prej të cilave «... mjerimi mirfilli ndjen trathti»<sup>17</sup>.

Një pjesë e mirë e poezisë dhe e prozës së Migjenit ka veçoritë e letërsisë së realizmit kritik, i cili shquhet nga pasqyrimi përmes kuadrosh tipike i kontradiktave shoqërore të kohës dhe karakterizohet nga kritika e ashpër kundra sistemit feudalo-borgjez.

Megjithëse poezitë e prozat e Migjenit janë të llojeve të shkurtëra, prapsepapë, na mund të hetojmë në to veçorinë themelore të realizmit, që, si e ka përcaktuar Engelsi, presupozon «paraqitjen me vërtetësi të karaktereve tipike në rrethana tipike»<sup>18</sup>.

Disa herë Migjeni bën thirrje për të përmbysur rendin në fuqi. Te «Poema e mjerimit» ai çfren me forcë:

«Mjerimi s'do mshirë. Por don vetëm të drejt!»<sup>19</sup>

Kurse në «Një natë pa gjumë»:

«Oh! ta kish e pishën të madhe edhe të ndezun!  
Me flakën e pishës në qiellin e ksaj nate  
ta shkruajshe kushtrimin... Ehu Burrë i tretun!  
Do ta shifsha vallen tande në maje të një shpate.»<sup>20</sup>

Karakteristikë e disa shkrimeve të Migjenit është përdorimi i mjeteve dhe i figurave të romantizmit. Të këtilla janë: «Shpirtent shtegtarë», «Kangë në vete», «Sokrat i vuejtun — apo derr i knaqun?», etj.

14) Në *Kishë*, vëllim i cituar, fq. 128.

15) *Zoti të dhashtë!*, vëllim i cituar, fq. 134-135.

16) *Rima e tretun*, vëllim i cituar, fq. 80.

17) *Poema e mjerimit*, vëllim i cituar, fq. 67.

18) Marksizmi dhe Engelsi për kulturën dhe artin, N.S.H. Botimeve «Naim Frashëri», Tiranë, 1960, fq. 33.

19) vëllim i cituar, fq. 70.

20) vëllim i cituar, fq. 105.

Poeti i këndoi një të ardhmeje të re, shprehu synimin e rinisë sonë drejt horizonteve dhe qëllimeve të larta. Synimi drejtë së ardhmes, patetika revolucionare përshkon poezitë «Të lindet njeriu...», «Zgjimi», «Shkëndija», «Kanga e rinis», «Ekstaza pranverore», etj.

Ishte dëshira e poetit që

«Të lindet një njeri  
i math si madhni  
dhe ndërgjegjet tona t'i ndezi në dashni  
për një idé të re, ideal bujâr,  
për një agim të lum e të drejtë kombtar.»<sup>21</sup>

Në emër të kësaj të ardhme në «Kangët e pakëndueme» ai ftonte:

«O vullnete të ndrydhuna!  
O vullnete të shtypuna!  
Shkundëni prangat të mbrapshta!...»<sup>22</sup>

Plot besim në ngadhnjimin e afërmë të së resë ai ngazëllonte se, «... lirija filloj me lulzue»<sup>23</sup> dhe se e ndjente «nga Dielli (alegorik) valën»<sup>24</sup>. Te «Dielli (alegorik)» edhe sikur të supozohej se bënte aluzion për Bashkimin Sovjetik, s'do të mjaftonte vetëm ky aluzion për ta quajtur atë vjershë të realizmit socialist. Për të dhënë një gjykim të tillë ajo duhet parë në kuadrin e krijimtarisë së poetit në tërësi.

Vjershat në të cilën gjetën pasqyrim dëshirat dhe ëndërat për t'ardhmen dhe u këndohet forcave, të papërcaktuara mirë, që do të shndronin dëshirat në realitet, i përkasin sipas nesh romantizmit revolucionar.

Në krijimtarinë e Migjenit vihet re kalimi prej krijimeve me frymë romantike në realiste kritike, kalim ky që vërehet edhe te shkrimtarë të tjerë, të huaj e vendës. Një vështrim i rendit kronologjik të botimit të saj nxjerr se disa prej prozave «Ose... — Ose...»<sup>25</sup>, «Tragjedi a po komedi?»<sup>26</sup>, katër nga «Kangët e Ringjalljes», «Të lindet njeriu...»<sup>27</sup>, «Zgjimi»<sup>28</sup>, «Shkëndia»<sup>29</sup>, «Kanga e rinis»<sup>30</sup>, që janë prej krijimeve të para të Migjenit (botuar më 1934 dhe 1935), mbajnë vulën e romantizmit.

Nga shqyrtimi i mësipërm arrijmë në përfundimin se është vështirë të pohojmë se, në vitet '30 në vendin tonë kishte një letërsi të realizmit socialist. Krijimtaria letrare e Migjenit nuk i përket letërsisë së realizmit socialist. Kjo metodë dhe rrymë letrare nuk mundi të zhvillohej në vitet '30 në Shqipëri, sepse mungonin premisat e domosdoshme historike-shoqërore. Vepra e Migjenit nga pikëpamja e metodës artistike është kryesisht realiste, kurse një pjesë e vogël i përket romantizmit revolucionar.

21) *Të lindet njeriu...*, vëllim i cituar, fq. 62.

22) *Zgjimi*, vëllim i cituar, fq. 63.

23) «*Kangët e pakëndueme*», fq. 65.

24) *Po aty*.

25) Gaz. «*Illyria*», Tiranë, 1934, nr. 14, 10 qershor, fq. 3.

26) *Po aty*, nr. 17, 1 korrik, fq. 3.

27) *Po aty*, 1935, nr. 21, 7 shtator, fq. 7.

28) *Po aty*, nr. 28, 26 tetor, fq. 7.

29) *Po aty*, nr. 30, 9 nëndor, fq. 3.

30) *Po aty*, nr. 32, 28 nëndor, fq. 7.

